



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



PROJEKTI FITUES ME TITULL:

“Përdorimi i metodave inovative në ndihmë të kërkimit shkencor për personelin akademik dhe studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës”

**FINANCUAR NGA UNIVERSITETI I TIRANËS ME PROGRAMIN
“UT-KËRKIM, EKSELENCË DHE INOVACION”
2023**

EKIPI I PROJEKTIT:

Prof. Asoc. Dr. Ogerta Koruti Stroka - drejtuese e projektit


Prof. Dr. Esmeralda Kromidha

Prof. Asoc. Dr. Elona Toro

Znj. Vasilika Mulla

PERIUDHA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT:

Qershor 2023 – Maj 2024



PËRSHKRIM I PROJEKTIT

Ky projekt kërkimor synon të paraqesë aspekte të ndryshme të integritit të teknologjisë në mësimdhënie e mësimnxënie dhe të kontribuojë në trajnimin e personelit akademik të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës.

Në këtë projekt, synohet të mblidhen të dhëna lidhur me nevojat më imediate në përdorimin e teknologjisë që kanë grupet e synuara gjatë realizimit të një kërkimi shkencor dhe më pas do të ndërtohet një program trajnimi në bazë të specifikave të nevojave të personelit akademik.



FGJH-UT ka ngritur nivelin e infrastrukturës teknologjike në ndihmë të kërkuesve shkencorë me laboratorë bashkëkohorë të Interpretimit dhe Përkthimit, Përkthim dhe Multimedia, Laboratorin e Fonetikës, Laboratorin e Kërkimit Shkencor dhe Integritit të Teknologjive në Mësimdhënie, Qendrën e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik si edhe Auditorin Multifunksional.



QËLLIMI

Ky projekt kërkimor synon të studiojë aspekte të ndryshme të integritit të TIK-ut në mësimdhënie/nxënie dhe trajnimin e personelit akademik të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja si edhe përfshin studime në lidhje me:

- situatën aktuale të përdorimit të TIK nga pedagogët dhe studentët e gjuhëve të huaja;
- nevojat e pedagogëve apo studentëve në zhvillimin e aftësive digjitale përmes TIK-ut;
- mjetet dhe teknikat që mund të zhvillojnë aftësitë në përdorimin e TIK-ut.

OBJEKTIVAT

Objektivat janë të shumëfishta:

- ❖ Hartimi i pyetësorëve dhe njohja e nivelit të aftësive digjitale tek Studentët e programit Master/Doktoratë dhe Pedagogët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës.
- ❖ Analiza e të dhënave të pyetësorit dhe hartimi i programit të trajnimeve mbi përdorimin e teknologjisë në ndihmë të nevojave të pedagogëve dhe studiuesve të rinj, evidentuar në hapin e parë.
- ❖ Hartimi i Udhëzuesit për kërkuesit e rinj që do të jetë i vlefshëm për përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor dhe në sinkron me standartet bashkëkohore.

REZULTATET

1. Plotësimi i një pyetësori me një numër të madh pedagogësh dhe studentësh të gjuhëve të huaja;
2. Shkrimi i një raporti për problemet e hasura dhe ndërtimi i një programi trajnimesh mbi përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie/nxënie dhe kërkim shkencor;
3. Shkrimi i një udhëzuesi të praktikave më të mira mbi integrimin e teknologjisë në kërkim shkencor dhe mësimdhënie/nxënie;
4. Shkrimi i të paktën 2 artikujve shkencorë.

